



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:158005

Datë: 29.09.2024

Numri i dokumentit: 06224520

**C.nr.2787/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.N. dhe A.D. nga Prizreni, të cilën me autorizim i përfaqëson av. N.C. nga Prizreni kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti: kompensim të inflacionit , me vlerë të kontestit 507.84 , jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 27 Shtator 2024, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

**I. APROVOHET** e bazuar kërkesëpadia e paditëseve A.N. dhe A.D. nga Prizreni **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëseve ti kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

- Paditësit A.N. nga Prizren, për periudhën kohore data 01.01.2020 e deri me datën 31.12.2021 shumën në lartësi prej 253.92 euro.
- Paditësit A.D. nga Prizren, për periudhën kohore data 01.01.2020 e deri me datën 31.12.2021 shumën në lartësi prej 253.92 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 507.84 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (30.05.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 176 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Paditësit A.N. dhe A.D nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre av.N.C. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 30.05.2024, me objekt kontesti kompensim nga marrëdhënia e punës , kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me vlerë të kontestetit 507.84 eur.

I autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit janë në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura në vendin e punës si mësimdhënës në institucionin shkollor "Mati Logoreci " në Prizren. E paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit me numër të protokollit 2056 , dt.18.04.2017, si dhe 105 të dt.22.01.2021 në mes të palëve në marrëveshje si, Sbashk, për të punësuarin Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dhe për Qeverinë e Kosovës/ Ministria e Arsimit, komfor dispozitave të nenit 35 par. 10 të marrëveshjeve të cekura, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe Kontratës individuale nuk ka bërë kompensimin e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Kosovës dhe (%) e inflacionit të futet në pagë prej datës 01.01.2020 deri në datën 31.12.2021. Në fund thekson se Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) është e obliguar që në bazë të fitimit të drejtës së paditëses ti ia paguajë kompensimin e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Kosovës dhe (%) e inflacionit të futet në pagë prej datës 01.01.2020 deri me datën 31.12.2021. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet komfor dispozitave (obligative) të Kontratës Kolektive të Arsimit (më konkretisht nenit 35 par.10), Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe kontratës individuale, andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Ka theksuar se paditësja nuk ka ofruar prova që është anëtare e sindikatës dhe i ka kaluar procedurat administrative sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, po ashtu me këto veprime i shkakton Komunës së Prizrenit shpenzime të mëdha, sepse e obligon që t'ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Po ashtu padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e

punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Gjithashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga Ministria e Arsimit, e paditura nuk mund të veproj në kundërshtim me planifikimin buxhetor. Gjithashtu ka theksuar se pretendimet e paditëses janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund thekson se në bazë të njoftimin të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/488 të datës 21.11.2022 për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2022 padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe sipas nenit 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2017 e deri më datën 07.12.2022 është parashkruar, sepse kanë kaluar mbi 3 vite, andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëseve është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimi me nr. protokoli 55/24 të datës 12.02.2024 për paditësin Ajriz Neziri e lëshuar nga SHFMU "Mati Logoreci" në Prizren, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek SHFMU "Mati Logoreci" në Prizren, si mësimdhënës, që nga viti 1985. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 588 euro, nga vërtetimi me nr. protokoli 54/24 të datës 12.02.2024 për paditësin Adnan Dilji e lëshuar nga SHFMU "Mati Logoreci" në Prizren, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek SHFMU "Mati Logoreci" në Prizren, si mësimdhënës, që nga viti 1985. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 588 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeks të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2 % ndërsa për vitin 2021 ka qenë 3.4 %. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se "Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën

*në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.*

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 02 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 588.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 680.61 euro ( $588 \times 0.2\% = 1.17 \times 12 \text{ muaj} = 14.04$  euro për selin paditës ) dhe për vitin 2021 ( $588 \times 3.4\% = 19.99$  euro  $\times 12 \text{ muaj} = 239$  euro për selin paditës ).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së ku parashihet që *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (12.01.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë

faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 156.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 176.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.2787/2024, datë 27 Shtator 2024**

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
**Gëzim Shehu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.